



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.23/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti-kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova-anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e [REDACTED] nga Prishtina, të paraqitur kundër Visar Hoti kandidat nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Miresjelljes për periudhën e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.12.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhen si të palejuara ankesat e ankueses [REDACTED] nga Prishtina, ZP.Anr.23/2025 dhe ZP.Anr.24/2025, të datës 18.12.2025, të paraqitur kundër Visar Hoti, kandidat nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Miresjelljes për periudhën e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 18.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat ZP.Anr.23/2025 dhe ZP.Anr.24/2025 të datës 18.12.2025, të dërguara me postë me datë 15.12.2025, të parashtruar nga [REDACTED] e cila përmes ankesës ZP.Anr.23/2025 pretendon se me datë 12 dhjetor 2025 në hapsirën publike, konkretisht në sheshin "Ali Ajeti", Besianë/Podujevë janë vendosur banerë/promote zgjedhore të kandidatit Visar Hoti nga subjekti politik LDK. Ky veprim është realizuar para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, e cila do të fillojë me 16 dhjetor, duke përbërë shkelje të rregullave ligjore për fushatën. Ndërsa, e njëjta përmes ankesës ZP.Anr.24/2025 ka bashkangjitur dëshmitë për ankesën ZP.Anr.23/2025, fotot e posterit me kandidatin Visar Hotin nga subjekti politik LDK, në Sheshin "Ali Ajeti", Besianë, me datë 12.12.2025, në ora 18:41.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datë 18.12.2025 ka theksuar se hedh poshtë pretendimet e ankueses [REDACTED] ngase e njëjta është ushtruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Nr.01/2025 Për Proceduraturë Parashtrimi dhe Vendosije së Ankesave, i cili shprehimisht thotë: Personi sipas nenit 4 të kësaj rregullore, ka të drejtë ankesë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor me pretendimin se i janë shkelur të drejtat e tij zgjedhore të përcaktuara më LZP-së, si në vijim: 1.1. nga data e shpalljes së ditës së zgjedhjeve, përfshi fushatën zgjedhore deri në hapjen e Qendrave të Votimit për votim; 1.2. nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, përfshi thyerjen e heshtjes zgjedhore në ditën e votimit si dhe për parregullsitë që ndërliiden me procesin e votimit; 1.3. pas ditës së votimit deri në shpalljen e

rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Tutje ka shtuar se ankesa në fjalë është bërë më 15 dhjetor 2025 pra para hapjes së fushatës zyrtare zgjedhore. Gjithashtu, ankesa edhe nëse do të ishte paraqitur sipas pikës më lartë e që nuk është paraqitur asisoji, do të cilësohej edhe si e pasafatshme sepse për paraqitjen e ankesës vlejnë edhe disa afate e që janë 24, respektivisht 48 orë nga pretendimi për shkeljen e supozuar 9 paragrafi 4 dhe 5 i Rregullores Nr.01/2025 Për Procedurat Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, kurse në këtë rast ankesa është bërë pas këtyre afateve apo saktësisht 72 orë më pas. Ankesa është ushtruar më datë 15 dhjetor 2025, për një pretendim të datës 12 dhjetor 2025 (pra 3 ditë pas, jashtë çdo afati), por kjo në këtë rast për më tepër edhe nuk vlen sepse nuk është brenda afatit zyrtar të fushatës zgjedhore. Për më tepër, për pretendimin ankimor ankuesja nuk e ka asnjë bazueshmëri ligjore, asnjë nen të cilit i referohet sepse nuk ka rregullim ligjor e as nënligjor për pretendimin e saj, dhe kësisoji lërkohet që ankesa të hudhet poshtë si e palejuar apo edhe si e pabazuar. As në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 Për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nuk ka asnjë dispozitë apo nen që flet për një kufizim të tillë apo pretendim të ankueses, për më tepër e njëjta ankesën e ka pa specifikim të shkeljes apo dispozitës ligjore apo nënligjore të shkelur, por vetëm përgjithshëm paraqet në ankesë një supozim të saj që nuk ka mbështetje ligjore.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.23/2025 dhe ZP.Anr.24/2025 të datës 18.12.2025, si dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZP.Anr.23/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankueses. Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës vëren se ankesa e ankueses është e palejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërisë së ankesës së ankueses Paneli iu referua nenit 33 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili nene normon Përgjegjësitë e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, ku në paragrafin 1 përcaktohet se *"1. Këtij Kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre. 2. PZAP-i ka autoritet ligjor të marrë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtij Kodi si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me procedurat e saj..."*

Kurse neni 34 përcakton se *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.1. heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik; 1.2. vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve; 1.3. mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbajtja e armëve nga personat e tjerë gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë të tilla janë të autorizuar për një gjë të tillë nga autoritetet përkatëse dhe që Policia e Kosovës është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara..."*

Po ashtu Paneli iu referuar edhe Rregullës Zgjedhore të KQZ-së Nr.15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme nenit 2 paragrafi 2 të saj i cili përcakton “2. Një ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve të parakohshme dhe/apo të jashtëzakonshme, KQZ nxjerr vendim për caktimin e afateve kohore dhe planin e aktiviteteve të zgjedhjeve për...” Ndërsa nën paragrafi 2.18, i nenit 2 përcakton se “për fushatën zgjedhore si dhe afatet për tubimin e fushatës zgjedhore.”

KQZ-ja me vendimin me nr.protokolli 01/3395-2025 i datës 24.11.2025 ka miratuar planin kohor të aktiviteteve për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 28 Dhjetor 2025, në të cilin plan ka përcaktuar se periudha për fillimin e fushatës zgjedhore fillon nga data 17.12.2025 dhe zgjat deri më datën 28.12.2025 në ora 06:59.

Prandaj duke u bazuar në vendimin e lartcekur të KQZ-së, si dhe në dispozitat e lartcekura ligjore me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesa nga pala ankuese e të cilat janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, përkatësisht më datë 12 dhjetor, Paneli vlerëson se ankesat e ankuesës janë të palejuara, ngase as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për periudhën kohore që i referohet para fushatës zgjedhore.

Bazuar në arsyet e sipërtheksuara, dhe duke u bazuar në nenin 115 paragrafi 1, i cili përcakton se “PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.” Dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, i cili përcakton se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht.” Po ashtu edhe në nenin 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se “PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”, lidhur me ankesën e ankueses vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZP.A.nr.23/2025, datë 19.12.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.